

# BLLOKU I SHËNIMEVE

# PËR KONFERENCËN E

# PËRGJITHSHME

**BËHU  
GATI!**

Përpara se të fillojë konferenca,  
mund të përgatitesh për ta  
dëgjuar zërin e Zotit duke kërkuar  
zbulesën tënde vetjake.

- A kam shpenzuar kohë për lutjen vetjake?
- A i kam lexuar shkrimet e shenjta?

**NJË VEND PËR TË MBAJTUR SHËNIM GJËRAT E  
TUA TË ÇMUARA TË ZBULESËS VETJAKE NGA  
KONFERENCA E PËRGJITHSHME.**

# PYET

Plaku Xhefri R. Holland ka dhënë mësim: "Zbulesa pothuajse gjithmonë vjen si përgjigje ndaj një pyetjeje".


## DHE MË PAS DËGJO

Konferenca e përgjithshme është një mundësi e mrekullueshme për të mësuar atë që do të donte Zoti që ti të dish e të bësh. Por nga e di se kur po të flet Ai? Kjo fillon me të menduarit për jetën tënde dhe për çfarë ke nevojë për ndihmë.

Ja disa gjëra për të cilat të mendosh:

Gjej pak kohë për të shkruar se çfarë drejtimi vetjak shpreson që Zoti do të të japë gjatë konferencës.

Ndërsa e dëgjon konferencën e përgjithshme, mbajti në mendje këto pyetje. Shpirti mund të të japë udhëzim të posaçëm.



## MBAJ SHËNIME

Ka shumë arsye përse njerëzit mbajnë shënime gjatë konferencës. Mbajtja e shënimeve mund të të ndihmojë që t'u kushtosh më mirë vëmendje dhe t'i mbash mend më mirë ato që ke dëgjuar. Kur mban shënime, i tregon Zotit se je gati të marrësh zbulesë vetjake dhe të veprosh sipas saj.

Provoje një herë! Teksa dëgjon konferencën, mos u shqetëso që t'i shkruash fjalë për fjalë gjërat që thonë folësit. Nëse humb diçka, gjithmonë mund të kthehesh dhe ta lexosh ose shikosh atë më vonë. Përqendrohu që të shkruash mendimet dhe mbresat e tua gjatë bisedave të tyre. Nëse i shkruan në çast, nuk do të të duhet të përipiqesh për t'i kujtuar më vonë.

Ajo që Thanë:

Ndjenjat dhe Mbresat e Mia:

A ke nevojë për disa këshilla mbi mënyrën se si ta bësh atë? Ja disa këshilla:

"Kur mbaj shënime në konferencë, nuk shkruaj gjithmonë me përpikëri atë që po thotë folësi/ja; unë shënoj drejtimin vetjak që Shpirti po më jep. Ajo që *thuhet* nuk është aq e rëndësishme sa ajo që *dëgjojmë* dhe ajo që *ndiejmë*."

Plaku Robert D. Hejls (1932-2017)<sup>2</sup>

Ajo që Thanë:



#### FTESA TË VEÇANTA

Udhëheqësit e Kishës shpesh japin ftesa për të na ndihmuar që të rritemi shpirtërisht. A ke dëgjuar ndonjë ftesë të veçantë gjatë sesioneve? Shkruaji këtu që të mos i harrosh!



Ndjenjat dhe Mbresat e Mia:



#### NDALO!

A ke marrë deri tani ndonjë përgjigje për pyetjet e tua? Nëse ke marrë, gjej një çast për të shkruar udhërrëfimin dhe drejtimin që ke marrë.



“Unë premtoj se, kur e dëgjoni zërin e Zotit për ju në mësimet e kësaj konference të përgjithshme dhe më pas veproni sipas atyre nxitjeve, ju do ta ndieni dorën e qiellit mbi ju dhe jeta juaj dhe jeta e njerëzve përreth jush do të bekohen.”

*Plaku Nil L. Andersen?*



"Bekimet më të mëdha të konferencës së përgjithshme vijnë te ne pasi përfundon konferenca. Kujtojeni modelin e shënuar shpesh në shkrimin e shenjtë: ne mblidhemi për të dëgjuar fjalët e Zotit, dhe kthehemi në shtëpitë tona për t'i jetuar ato."

Plaku Robert D. Hejls<sup>4</sup>



Ajo që Thanë:



Ndjenjat dhe Mbresat e Mia:



**NDALO!**

A ke marrë ndonjë ide tjetër rreth gjërave që ke nevojë të vazhdosh të bësh, të mos i bësh më apo të fillosh t'i bësh që ta përmirësosh jetën tënde?



**FTESA TË VEÇANTA**

Udhëheqësit e Kishës shpesh japin ftesa për të na ndihmuar që të rritemi shpirtërisht. A ke dëgjuar ndonjë ftesë të veçantë gjatë sesioneve? Shkruaj këtu që të mos i harrosh!

# ÇFARË KAM PËR TË BËRË MË TEJ?

Çfarë përvoja e mrekullueshme ka qenë të dëgjojmë dëshmitë e apostujve dhe të profetëve! A more drejtim që mund të të ndihmojë në jetën tënde?

Tani është koha e shkëlqyer të vendosësh synime që të ndihmojnë të veprosh sipas gjërave që ke mësuar. Këtu janë disa ide:

- Zgjidh një ose dy pjesë të drejtimit të posaçëm dhe krijo një plan për të vepruar.
- Bëj një plan për të vepruar sipas njëres prej sfidave ose ftesave që dëgjove.
- Dëgjo një bisedë konference çdo mëngjes ndërkohë që bëhesh gati për shkollë.
- Tregoja njëren nga historitë ose citimet e tua të parapëlqyera nga konferenca një shoku apo shoqeje ose shpërndaje në mediat shoqërore.
- Planifiko një kohë kur familja jote mund të flasë për atë që i bëri përshtypje secilit prej tyre gjatë konferencës.
- A ke ndonjë ide tjetër? Shkruaje synimin tënd vetjak:

---



---



---



---

Përdor gërshërë që ta presësh këtë pjesë të kësaj faqje. Më pas mund ta vësh në një vend ku do ta shohësh çdo ditë për të të kujtuar synimet e tua.





“Përgjigjet ndaj lutjeve tuaja të veçanta mund të vijnë drejtpërsëdrejti nga një bisedë e caktuar ose nga një frazë e veçantë. . . . Një dëshirë më e zellshme për t’i dëgjuar dhe ndjekur fjalët e këshillës do ta përgatitë udhën për zbulesë vetjake.”

Plaku Dieter F. Uchtdorf<sup>5</sup>

### Shënime

1. Jeffrey R. Holland, “Cast Not Away Therefore Your Confidence”, *Ensign*, mars 2000, f. 9.
2. Robert D. Hejls, konferenca e përgjithshme e tetorit 2013 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2013, f. 6).
3. Nil L. Andersen, konferenca e përgjithshme e tetorit 2017 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2017, f. 126).
4. Robert D. Hejls, konferenca e përgjithshme e tetorit 2013 (*Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2013, f. 7).
5. Dieter F. Uchtdorf, “General Conference – No Ordinary Blessing”, *Ensign* ose *Liahona*, shtator 2011, f. 4.


© 2022 by Intellectual Reserve, Inc.  
All rights reserved.

LEJA PËR TA RISHYPUR NË LETËR KËTË BROSHURË JEPET PËR PËRDORIM VETJAK, JO PËR TREGTI. KJO PËRFSHIN LEJEN PËR UDHËHEQËSIT E LAGJES, PËR TË SHYPUR NË LETËR NJË NUMËR TË VOGËL KOPJESH, PËR ATA QË SHËRBEJNË BRENDË KUADRIT TË THIRRJEVE TË TYRE. BROSHURAT DUHET TË SHYPEN TË PLOTA. KJO NUK PËRFSHIN LEJEN QË KY MATERIAL TË AFISHOHET NË INTERNET, TË RIPËRDORËT OSE TË SHPËRDAHET. ÇDO PËRDORIM SHITESË I KETIJ MATERIALI KËRKON LEJE.

[permissions.ChurchofJesusChrist.org](https://permissions.ChurchofJesusChrist.org)

### KE NEVOJË PËR MË SHUMË KOPJE?

Shkarkoje dhe shtype në letër këtë bllok shënimesh te [conference.ChurchofJesusChrist.org](https://conference.ChurchofJesusChrist.org).



KISHA E  
JEZU KRISHTIT  
E SHENJTORËVE TË  
DITËVE TË MËVONSHME